



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0207

OSHP: 2024/0209

OSHP: 2024/0213

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “SINJALIZIMI” SH.P.K., OE “TSR” SH.P.K., si dhe OE “N.SH. LIRIU”, kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “Komuna PRIZREN”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit” projekt me numër të prokurimit 622-23-13919-5-1-1, me 14/05/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “SINJALIZIMI” SH.P.K., me nr. 2024/0207, e datës 13/03/2024 dhe OE “TSR” SH.P.K., me nr. 2024/0209, e datës 13/03/2024, si dhe OE N.SH. “Liriu” me nr. 2024/0213, e datës 14/03/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit” projekt me numër të prokurimit 622-23-13919-5-1-1.
2. Anulohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër të prokurimit: 622-23-13919-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues, “Komuna PRIZREN”, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik “SINJALIZIMI” SH.P.K., “TSR” SH.P.K., N.SH. “Liriu”, sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të

kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 13.02.2023, “Komuna PRIZREN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit” me numër të prokurimit 622-23-13919-5-1-1. Ndërsa me datën 23.02.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë GOE “TRAFFIKS VA SH.P.K.; MILENIUM KONSTRUCTION “ SH.P.K

Me 28.02.2024, OE “SINJALIZIMI” SH.P.K., “TSR” SH.P.K., dhe N.SH. “Liriu”, kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 04.03.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit i ka refuzuar si të pa bazuara ankesat e dy Operatorëve Ekonomik dhe te OE N.SH. “Liriu” e ka aprovuar pjesërisht dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 13.03.2024, OE “SINJALIZIMI” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2024/02027 ndërsa me datë 13.03.2024 OE “TSR” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2024/0209, si dhe OE N.SH. “Liriu”, me datën 14.03.2024 ka parashtruar ankesë ne OSHP me nr.2024/0213.

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

Duke ju referuar ankesave si më sipër, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, konstatohet paraprakisht se lidhur me çështjen në rastin konkret, gjen zbatim neni 16 (Rastet e unifikuara) i Rregullores së cituar, sipas të cilit Kryetari i OSHP ka të drejtë që ti bashkoj Lëndët/ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve ankimore janë të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe ka të drejtë të vendos i njëjti Panel

shqyrtues.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar.

Lidhur me këtë konstatohet se:

→ Raportet e ekspertizave me Nr.2024/0207, Nr.2024/0209, Nr.2024/0213, datës 25.03.2024, përmban rekomandimet si në vijim:

Ankesat e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuara,

Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim;

Raportet e ekspertizës i përmbajnë elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe të njëjtit janë pranuar nga palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se, AK lidhur me raportin me Nr.2024/0207, nuk pajtohet me aprovimin e pjesërisht të ankesës, ndërsa OE “SINJALIZIMI SH.P.K.” është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues. Lidhur me raportin e ekspertit me Nr.2024/0209 AK nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit ndërsa OE “TSR” SH.P.K. nuk është deklaruar se a pajtohet apo jo me rekomandimin e ekspertit. Si dhe lidhur me raportin e ekspertit me Nr.2024/0213 AK nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit, ndërsa OE “N.SH LIRIU” pajtohet me rekomandim të ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim, por jo edhe me përgjigjet e ekspertit në pretendimet e tyre.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në këtë rast Paneli konstatoi se AK ka zbatuar:

- a. procedurë të hapur;
- b. lloji i kontratës: Punë;
- c. vlera e parashikuar e kontratës: 1,000,000.00 €.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

a. *Pohimet ankimore të OE “SINJALIZIMI SH.P.K.”*

Ankuesi ka atakuar vendimin e autoritetit kontraktues rreth eliminimit të tij/saj, ku sipas AK, ankuesit i mungojnë mungojnë referencat e natyres se kontrates sa vlera e kerkuar ne dosje te tenderit dhe njoftimit per kontrate; Një udhëheqës të vend-punishtes - Inxhinier I Inxhinierisë Mekanike drejtimi komunikacion (trafik dhe transport rrugor) me përvojë pune në menaxhimin e punimeve të sinjalizimit rrugor (së paku 3 vite përvojë pune) (,mungon pervoja e punes ne menaxhimin e punimeve te sinjalizimit rrugor nuk ka ndonje referenc; Paisjet teknike – mungojn keto paisje: 1 (një) makinë për realizimin e sinjalizimit horizontal me ngjyrë me 2 komponentë. 1 (një) makinë tharëse (shërben për tharje të sipërfaqes e cila do të sinjalizohet). 1 (një) Reflektometer për matje të reflektimit sipas standardit EN 1436 për RL dhe Qd – nëse instrumenti është i prodhuar më shumë se 3 vjet, duhet të ketë certifikatë të kalibrimit. 1 (një) Instrument për matje të trashësisë së ngjyrës I cili mund të mas trashësin e ngjyrës së terur ose të lagësht ose te dyja 1 (një) rimorkio të lehtë, me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve në rrugë 1 (një) semafor mobil, me njësi kontrollues, me bateri që mundëson punë 72 orë konstante, me diametër të dritave fi 200 ose fi 300, si dhe me pjesët tjera përcjellëse që mundësojnë funksionimin e tyre; Autorizimin I prodhuesit apo dilerit te autorizuar për materialet e sinjalizimit horizontal (për ngjyrën e thjesht, për termoplastik, për perlën reflektuese); Autorizimi I prodhuesit apo dilerit të autorizuar për pajisjet semaforike. Lidhur me të gjitha këto pretendime eksperti shqyrtues nuk ka ardh tek ndonjë konstatim nëse ankuesi është i përgjegjshëm apo jo, për derisa dokumentet i ka në gjuhën Sllovene, përveç sa i përket udhëheqësit të vend punishtes. Tutje, Pas analizmit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, ekspertja shqyrtuese sqaron se, meqenëse anëtari I konzorciumit është Slloven, si rrjedhojë OE ankuesi në ofertë ka të bashkangjitura shumicën e dokumenteve në gjuhën jo zyrtare, të cilat I njëjti është dashur që ti përkthejë, në mënyrë që komisioni I vlerësimi të mund të vlerësoj ofertën me lehtë dhe më sakt. Si e tillë, pas analizmit të pretendimeve, ekspertja shqyrtuese vlerëson se të gjitha pretendimet e OE ankues gjenden pjesërisht të bazuara, për faktin se dëshmitë/dokumentet në ofertë janë në gjuhë jo zyrtare, dhe nuk mund ta konstatojmë përgjegjshmërinë ose papërgjegjshmërinë e tij, andaj rekomadoj AK-në që lëndën ta kthej në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideron se operatori ekonomik ankues me rastin e aplikimit në këtë procedurë të tenderimit me dokumente në gjuhën Sllovene ka aplikuar në kundërshtim me nenin 13 të LPP, i cili citon: “4.Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”, andaj, administrativisht është i papërgjegjshëm për këtë procedurë. Kjo nisur nga fakti se secili pjesëmarrës duhet me qenë i vetëdijshëm për mënyrën e aplikimit dhe gjuhën zyrtare dhe dispozitën e lartcekur, si dhe afatin

kohor në dispozicion për aplikim në tender prej 40 ditësh. Këtë fakt ankuesi në ankesën e tij nuk e potencon fare.

Sa i përket listës së kontratave dhe referencave ankuesi as në kërkesë për ri-shqyrtim dhe as në ankesë nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se i njëjti e plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit. Përveç kësaj lista e kontratave është me kontrata në gjuhën Sllovene, edhe lista përmban të meta, sepse nuk e kanë as natyrën e aktiviteteve, emrin e plotë të personave juridik, i njëjti nuk ka bashkangjitur dëshmi tjera që do ta vërtetonte nëse të njëjtat janë të përfunduara me suksese, qoftë nëse është e nevojshme edhe me qarkullim bankar, nëse të njëjtat a janë me blerës publik apo blerës privat, ashtu sikurse e kërkon neni 69 i LPP, për me dëshmu përgjegjshmërin e tij.

Po ashtu, edhe listën e pajisjeve e cila është pothuajse e gjitha në gjuhën jo zyrtare të përcaktuar në nenin 13 të LPP, që sipas opinionit të KRPP Nr. 13, të publikuar në ueb faqen e e-prokurimit, thotë se, Neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4 të LPP. Pra, sjellja e dokumenteve në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë e OE.

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit. Specifikimet teknike pjesë thelbësore e tenderit, prandaj, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet. KRPP, përmend edhe dokumentet që kanë të bëjnë me nenet 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së **mund** të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument. Por, kjo dispozitë nuk i ka vënë karakter detyrues AK-së që të kërkoj sqarime, dhe është përgjegjësi e vet AK-së që të vlerësoj se a duhet të kërkoj sqarime apo jo, po ashtu, ka mundësi që të kërkojen sqarime për ndonjë dokument eventual e jo për shumicën e ofertës prej qindra faqesh.

Çështja tjetër që është shumë me rëndësi për Panelin Shqyrtues është edhe çështja e dy autorizimeve për të cilat është eliminuar ankuesi: Autorizimin I prodhuesit apo dilerit të autorizuar për materialet e sinjalizimit horizontal (për ngjyrën e thjesht, për termoplastik, për perlën reflektuese); Autorizimi I prodhuesit apo dilerit të autorizuar për pajisjet semaforike, ndërsa, ankuesi në kërkesën për ri-shqyrtim dhe ankesën në OSHP e përmend vetëm një autorizim që është i bashkangjitur në ofertë, ndërsa tjetrin nuk e përmend por deklaron se duhet me u kërkuar sqarime shtesë pa e bashkangjitur të dy autorizimet se i posedon dhe të njëjtat të jenë konform kërkesës së Dosjes së tenderit. Ankuesi e posedon një autorizim në ofertën e tij, po autorizimi përmban datën e vitit 2019 dhe është i përgjithshëm, pa u specifikuar “për materialet e sinjalizimit horizontal (për ngjyrën e thjesht, për termoplastik, për perlën reflektuese)” apo “për pajisjet semaforike”. Dhe në folderin Nr. 12 të cilën e përmend ankuesi është autorizimi, por dokumentet përcjellëse përfshirë atestet dhe specifikat e produktit janë në gjuhë jo zyrtare dhe jo të lejuara me nenin 13 të LPP dhe opinionin e KRPP.

Lidhur me udhëheqësin e vend punishtes sa i përket referencave, për të njëjtat mund të kërkohej sqarime shtesë, përshkak se ankuesi ka ofruar prova disa referenca të cilat mund të verifikohen konform nenit 52.7 të LPP, por tani në këtë fazë për ankuesin është irelevante për shkak se administrativisht aplikimi i tij/saj nuk është konform LPP.

b. *Pohimet ankimore të OE "TSR" SH.P.K.*

Ankuesi ka atakuar përzgjedhjen e OE të rekomanduar nga AK, duke pretenduar se është i papërgjegjshëm në disa pika: Sa i përket kontratave të realizuara; nuk ka dëshmuar se ka kryer të paktën një projekt në instalimin ose mirëmbajtjen e sinjalizimit ndriçues, udhëheqësen e punishtes znj.R.S, për të cilën i njëjti pretendon se nuk e plotëson kërkesën sa i përket përvojës; nuk e plotëson kërkesën për 1 (një) rimorkio, sepse nuk ka dëshmi të certifikatës për kontrollim teknik dhe se afati i kontrollës ka skaduar. pajisjen 1 (një) instrument për matjen e trashësisë së ngjyrës, për të cilën pohon se i njëjti nuk ka dëshmuar as DUD doganor ose faturë të blerjes; autorizimi i prodhuesit ose dilerit nuk është për të gjitha pajisjet e kërkuara për këtë aktivitet të prokurimit, por kompania prodhon vetëm një produkt "Light Panel School Zone", si dhe nuk ka ofruar autorizim mbi përfaqësinë e kompanisë por vetëm letër konfirmime nga këto firma; pajisja 1 (një) semafor mobil nuk posedon dëshmi të mjaftueshme, por vetëm një faturë, kurse firma në specifikacionin teknik me emrin e firmës në foto nuk përkojnë; disa deklarata të cilat OE i rekomanduar i ka sjellë në sqarim, ku i njëjti pohon se kanë datë të lëshimit pas hapjes së ofertave; AK ka shkelë vendimin e Qeverisë së Kosovës, për faktin se ka rekomanduar një OE i cili posedon Autorizimin se do të furnizoj me produkte serbe. Lidhur me këto në raportin e ekspertizës janë të sqaruar të gjitha nga ana e ekspertit shqyrtues, i cili po ashtu si përfundim ka deklaruar se OE ankuesi si OE i pa sukseshshëm me çmimin më të lartë në këtë aktivitet të prokurimit, ka parashtuar pretendime ankimore kundër OE të rekomanduarit, ku pretendimi i dytë, tretë, gjashtë dhe nëntë, nuk gjenden të bazuara, ndërsa pretendimet i parë, katër, pesë, shtatë, dhe dhjetë gjenden pjesërisht të bazuara, me të cilat nuk mund të konstatohet papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar, ndërsa vetëm pretendimi i parë dhe i tetë vlerësoj se duhet të verifikohet në detaje nga AK.

Paneli shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore kanë krijuar bazë të mjaftueshme që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe autoriteti kontraktues të kërkon sqarime dhe të bëjë verifikime lidhur me dyshimet e ngritura konform nenit 52.7 të LPP, në pretendimet 1 dhe 8 të radhitura në raportin e ekspertit.

Lidhur me pretendimin ankimor se AK ka shkelë vendimin e Qeverisë së Kosovës, për faktin se ka rekomanduar një OE i cili posedon Autorizimin se do të furnizoj me produkte serbe. Eksperti shqyrtues sqaron se, AK në DT nuk ka specifikuar se nuk mund të ofertoni me produkte serbe, sipas Vendimit të Qeverisë, andaj lidhur me autorizimin OE i rekomanduar nuk ka qenë i njoftuar. para se autoriteti kontraktues ta shpallte fitues, ka qenë dashtë që të kërkoj një sqarim apo interpretim nga organet gjegjëse. Me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues, Paneli Shqyrtues nuk pajtohet, ngase secili AK në Kosovë është i obliguar të respektoj vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, andaj, autoriteti kontraktues ka qenë dashtë fillimisht të kërkoj opinion

dhe sqarim nga organet gjegjëse dhe OE se këto produkte a mund të lejohen të hyjnë në Kosovë.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimore sa i përketudhëheqësit tëpunishtes znj.R.S, për të cilën i njëjti pretendon se nuk e plotëson kërkesën sa i përket përvojës. Eksperti sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar gjendet Diploma me nr.466 e cila tregohet se ka përfunduar studimet me datë 15.03.2021 dhe është pajisur me diplomë me datë 26.03.2021, mirëpo e njëjta posedon referenca dhe dëshmi e cila ka përvojë mbi tri vite përvojë pune, kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me afatin kohor të diplomës me eksperiencën, ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi nuk gjendet i bazuar për faktin se kjo kërkesë nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit, pra AK nuk ka kërkuar përvojën tri vjeçare pas diplomimit, përkundër që data e njoftimit për kontratë është 13.12.2023. Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në vendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë për Çështje Administrative A.nr,2276/2014, konsideron se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit, ngase, edhe gjykata në vendimin e lartcekur vlerëson se përvoja e punës në profesion duhet të llogaritet pas datës së diplomimit, e jo të llogaritet edhe përvoja e punës para diplomimit.

Pohimet ankimore të OE “N.SH. Liriu”

Ankuesi ka atakuar përzgjedhjen e OE të rekomanduar nga AK, duke pretenduar se është i papërgjegjshëm në disa pika: AK ka shkelë nenin 62 të RRPP-së dhe nenin 108/A të LPP-së; (një) semafor mobil, me njësi kontrollues, me bateri që mundëson punë 72 orë konstante, me diametër të dritave fi 200 ose fi 300, si dhe me pjesët tjera përcjellëse që mundësojnë funksionimin e tyre. GEO i shpallur fitues në këtë fazë ka paraqitur fakte dhe dëshmi të pavërteta, me këtë rast ka tentuar të mashtrij AK në lidhje me posedimin e këtyre paisjeve; OE i rekomanduar për këtë kërkesë ka paraqitur inxhinieren Rina Sinani, e cila ka mbaruar studimet me datës: 15.03.2021 dhe periudhën tre vjeçare e arrin me 15 Mars 2024; Autorizim nga kompania Signal nga Serbia e cila sipas dokumenteve të bashkangjitura është përfaqësues për shtetet të cilat janë cekur: Serbia, Mali I zi, Maqedonia V. dhe Shqipëria. Ne këtë dokument askund nuk thuhet se është përfaqësues për Kosovë, pra për këtë kriter OE i propozuar për kontratë në këtë fazë, me këtë marrëveshje dhe me këtë **autorizim nuk mund të operoj në Kosovë** për shkak se vet autorizim dhënësi nuk ka autorizim që këto folje ti përdorë në shtetin e Kosovës siç është kërkuar me DT; OE nuk ka paraqitur Fatura origjinale, deshmi te pageses ne emer te faturave per te deshmuar se e arrin vleren e caktuar. Ne kontratat e ofruara, ku si nenkotraktor i kompanive qe kanë kontratat me AK publike, nuk jan paraqitur Procesverbalet e pranimit Teknik apo Referencat qe AK I ka leshuar kompanive ku OE i shpallur fitues ka qene I nënkontraktuar; OE nuk ka ofruar ne as nje formë deshmi zotim apo katalog per produktet e paisjeve te trafikut rrugor; Çmimet e ofruara te paisjet e Semaforave janë çmime jo normalishtë te ulëta. Lidhur me këto në raportin e ekspertizës janë të sqaruar të gjitha nga ana e ekspertit shqyrtues, i cili po ashtu si përfundim ka deklaruar se OE ankuesi si OE i pa sukseshshëm me çmimin më të lartë në këtë aktivitet të prokurimit, ka parashtruar pretendime ankimore kundër OE të rekomanduarit, ku pretendimi i parë gjendet i bazuar, mirëpo nuk është që ndryshon gjendjen, tutje pretendimi i katërt, pestë, gjashtë dhe shtatë, gjenden pjesërisht të bazuara, ndërsa

pretendimet tretë, nuk gjenden të bazuara, me të cilat pretendime të shqyrtuara nuk mund të konstatohet papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar, kurse vetëm pretendimi I dytë dhe i pestë vlerësoj se duhet të verifikohen në detaje nga AK, të cilat pretendime po ashtu janë të ngritura edhe në lëndën me nr.209/24 për të njëjtin aktivitet të prokurimit, andaj ekspertja shqyrtuese obligon AK-në që të kërkoj sqarime dhe të verifikoj faturën me katalogun, listën e projekteve dhe dëshmitë, të cilat pretendime e kualifikojnë ose e diskualifikojnë OE të rekomanduarin.

Paneli shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore kanë krijuar bazë të mjaftueshme që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe ka ngritur dyshime për falsifikime dhe mashtrime, andaj, autoriteti kontraktues të kërkon sqarime dhe të bëjë verifikime lidhur me dyshimet e ngritura konform nenit 52.7 të LPP, në pretendimet e ankuesit. Po ashtu, sikurse edhe në vendimet tjera, OSHP njofton palët se për secilin dyshim apo falsifikim të ju drejtohen organeve kompetente të hetuesisë, ngase, OSHP nuk ka kapacitete teknike dhe profesionale për të bërë verifikimin e tyre.

Paneli Shqyrtues nuk do të lëshohet në shqyrtim të pretendimeve tjera, për shkak se në shumicën prej tyre janë dhënë përgjigje në ankesën NR. 2024/0209 dhe OE nuk e ka plotësuar kërkesën e DT sa i përket udhëheqësit të punishtes, kështu që, nuk ka nevojë të lëshohemi në secilin pretendim ankimor dhe të njëjtat të përsëriten.

Në bazë të këtyre pretendime të lartcekura të ngritura me ankesat Nr. 2024/0209 dhe 2024/0213, mund të konstatohet se AK përveç që ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, konkretisht nenin 108/A, duke mos u përgjigjur dhe arsyetuar përgjigjet në pretendimet ankimore, i njëjti ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues bazuar edhe në rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe aktiviteti i prokurimit me titull “Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit” me numër të prokurimit: 622-23-13919-5-1-1, të kthehet në Rivlerësim. Pra, Paneli Shqyrtues konsideron përfundimisht se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast është vërtetuar se përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

- Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,6,7,27,28 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë. Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre.

Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili kanë paqartësi me kërkesat dhe me specifikat e kërkuara DT, do duhej që në fazën paraprake, ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK.

Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Kjo siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjithë palët e interesuara. Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit.

Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit. Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të

tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente. Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - SINJALIZIMI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: